



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.98/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevcu anëtar, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Anita Peci, duke vendosur përkritazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Pejë, për shkak të vendosjes së posterëve të kandidatëve në trupa të lisave publik, për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me 03.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet si e bazuar ankesa e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV), me seli në Prishtinë, kështu që subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), dega në Pejë, i shqiptohet dënimi me gjobë në vlerë prej 550.00 (pesëqind e pesëdhjete) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimi të këtij vendimi nën kërcënim të përmbarimit.

A r s y e t i m

Me datën 29.09.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me të cilën pretendon se me datën 29.09.2017, në trupat e lisave publik që gjenden në rrugën “Mbretëresha Teutë” në Pejë, ishte vendosur poster i kandidates për Kryetare të Kuvendit Komunal të Pejës, nga radhët e subjektit politik PDK.

Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e dispozitës së nenit 33 pika b), të LPZ-së, të dispozitës së nenit 4.1 pika b të Rregullës Zgjedhore nr.11/2013 dhe nenit 3.4 të Rregullës Zgjedhore nr. 13/2013 të KQZ-së.

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur një fotografi lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigje në ankesë të datës 30.09.2017, subjekti politik PDK, konsideron se shkelja nuk është e qëllimshme dhe se kjo është bërë nga aktivist të pa informuar mirë me rregullat zgjedhore. Përkundër kësaj dega e partisë në Pejë ka ndërmarr masat e duhura për të përmirësuar shkeljen e pretenduar.

Në mbështetje të pretendimeve ka bashkangjitur një fotografi në të cilën shihet se është larguar poster i nga vendi ku ka qenë i vendosur.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e bazuar

Nga fotografia e ofruara si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet se posteri i kandidatës për Kryetare të Kuvendit Komunal nga subjekti politik PDK, është vendosur në hapësirë publike përkatësisht në trupat e lisave publik, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së e cila përcakton “*Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në hapësira apo në rrugë publike*”

Duke u nisur nga gjendja e konstatuar faktike, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e subjektit politik PDK, është shkelur neni 33, pika b), të LZP-së, pasi që posteri i kandidatës për Kryetare të Kuvendit Komunal nga ky subjekt, është vendosur në hapësirë publike përkatësisht në trupat e lisave publik.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret, se subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara, që do të thotë se janë të njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe për kundër këtij fakti posteri i kandidatës për Kryetare të Kuvendit Komunal të këtij subjekti politik është vendosur në hapësirë dhe në rrugë publike. Po ashtu si rrethanë, PZAP-i e mori edhe faktin se subjektit politik në fjalë, ia dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre shihet qartë se brenda afatit të caktuar kanë ndërmarrë veprime për të bërë përmirësimin e shkeljes ashtu që kanë hequr posterin nga vendi i palejuar ku ka qenë i vendosur, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
ZL.Anr.98/2017 me datën 03.10.2017.

Kryesues i Panelit
Hasan Shala



Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.